

Hapet thirrja për aplikime për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Nysës, në Poloni, në Kuadër të Programit Erasmus +, për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Nysës, në Poloni për semestrin e dytë të vitit akademik 2018-2019.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

Kohëzgjatja e bursave:

- Stafi akademik për mësimdhënie (5 ditë + 2 ditë udhëtim);

Fushat e studimit:

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit në gjuhën angleze të ofruar nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Nysës, Poloni, klikoni në adresën:

Finance and Accounting

http://www.pwsz.nysa.pl/sitecontent/bwm_en/pliki/erasmus+finance_offer_2017-2018.pdf

English Philology

http://www.pwsz.nysa.pl/sitecontent/bwm_en/pliki/erasmus+english-studies_dla-bwm_sept_2018.pdf

Business English http://www.pwsz.nysa.pl/sitecontent/bwm_en/pliki/business_english.pdf

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm) | Kompensimi |
|--|-------------------|
| Midis 100 dhe 499 KM | 180 EUR |
| Midis 500 dhe 1999 KM | 275 EUR |
| Midis 2000 dhe 2999 KM | 360 EUR |
| Midis 3000 dhe 3999 KM | 530 EUR |
| Midis 4000 dhe 7999 KM | 820 EUR |
| 8000 KM ose më shumë | 1100 EUR |

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni link-ut:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

➤ Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie:

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);

- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë një mobilitet Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Afati për aplikim: 10 Janar 2019

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara në formatin PDF në adresën iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të kontaktoni me Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën e e-mail: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!